



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Njoftim publik

05 Nr. 015/02-162939/25 dt. 24.10.2025

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në kërkesën 05 Nr. 015/02-162939/25 dt. 24.10.2025, e aplikuesit CC Apartaments LLC në Çagllavicë si dhe të Nenit 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Vendimin 01 nr. 031 -223419 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Neni 6, pika 1.2., pika 1.2.1., pika 1.2.1.2. dhe pika 1.2.2., Neni 7, pika 1, pika 2 dhe pika 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPH – së, ka proceduar emërtimin e rrugës së re, me kod të veçantë (kodi 12329) dhe ka bërë propozimin për emërtim të rrugës në bashkëpunim me aplikuesin në ZK Çagllavicë, Prishtinë.

Emri i propozuar nga vetë aplikuesi për rrugën me kod 12329: **BESIM JASHARI** – Ishte Dëshmorë i Familjes emblemë e kombit shqiptar, Familja Jashari.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 25.10.2025 deri më 01.12.2025, në E-mail adresën: urbanizmi@prishtine.gov.net

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPH –së, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal, neni 7, paragrafët 1 dhe 2, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në web-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në web-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përkshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë si dhe kodi i rrugës përkatëse.



Nënshkrimi i Zyrtarit

